



I nderuar Di Bella - Shef i Misionit të FMN-së për Kosovë

Të nderuara Media

Fillimisht më lejoni të falënderoj Fondin Monetar Ndërkombëtar për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës, e në veçanti Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në realizimin e detyrave të saj në mbajtjen dhe ruajtjen e një sistemi financiar stabil dhe vazhdimisht në rritje.

Gjatë takimeve të zhvilluara me përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar, i informuam lidhur me zhvillimet dhe të dhënat e fundit të sistemit financiar në Kosovë. Sistemi financiar në Kosovë ka vazhduar të jetë likuid dhe mirë i kapitalizuar, ku në të gjithë indikatorët ka shënuar rritje dyshifrore duke qenë një nga faktorët e rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Gjithsej mjetet e sistemit financiar në vend, më 31 gusht 2022, kanë arritur vlerën e përgjithshme prej 9.3 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 10 përqind.

Ndërsa, mjetet e sektorit bankar kanë vazhduar trendin e rritjes edhe gjatë vitit 2022, duke arritur vlerën rreth 6.4 miliardë euro në muajin gusht 2022, e cila paraqet një rritje vjetore prej 11.1 përqind.

Në gusht 2022, vlera e përgjithshme e depozitave është në vlerë prej 5.2 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.8 përqind, derisa rritja e depozitave ka vazhduar edhe gjatë muajit shtator, me një prej 12.7 përqind.

Sektori bankar vazhdon të jetë i qëndrueshëm duke rritur aktivitetin kredidhënës dhe duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në kreditimin e ekonomisë së vendit edhe gjatë këtij viti. Vlera e portofolit kreditor të sektorit bankar në fund të gushtit 2022, ishte në shumë prej 4.2 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 18.6 përqind, derisa norma mesatare e interesit për kredi ishte 6.0 përqind.

Kreditë joperformuese kanë vazhduar me trendin rënës dhe sot norma e kredive joperformuese është në nivelin prej 2.1%, që është tregues dukshëm më i mirë krahasuar me vendet e regjionit apo edhe më gjerë.

Spektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar dhe likuid. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar shënon 16.1 përqind, që është dukshëm mbi kërkesat rregullatore prej 12 përqind, ndërsa treguesi i likuiditetit është 35.7 përqind, ngjashëm, më lartë se kërkesa rregullatore prej 25 përqind.

Rezultate pozitive kemi edhe në sektorin e sigurimeve dhe sektorët e tjerë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është e sigurt që do të vazhdojë të ketë edhe më tutje përkrahjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe do të vazhdojmë bashkëpunimin e suksesshëm me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Edhe njëherë me lejoni të falënderoj përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar për kontributin dhe përkrahjen e vazhdueshme të Kosovës dhe të Bankës Qendrore.

Faleminderit